



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



KRYETARI I KOMUNËS  
MUNICIPAL PRESIDENT  
PREDSIEDNIK OPSTINE

Tel / Fax: 038/200-46002  
Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.  
E-mail: [info.ferizaj@rks-gov.net](mailto:info.ferizaj@rks-gov.net)

|                 |            |
|-----------------|------------|
| DATA/DATUM/DATE | 22.07.2026 |
| 01 NR/BR.       | 205/ 26    |

|                       |                                                                                                                                   |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| PËR/ZA/TO             | Kuvendin e Komunës.                                                                                                               |
| PËRMES/PREKO/RTHROUGH | Komitetit për Politikë dhe Financa<br>Kryesuesit të Kuvendit të Komunës<br>Xhavit Zariqi                                          |
| NCA/OD/FROM           | Kryetar i Komunës<br>z. Agim Aliu                                                                                                 |
| LËNDA/PREDMET/SUBJECT | Propozim Vendim për ngritjen e tarifave, ndryshimi<br>të Rregullores 01. Nr. 124 për Parkingjet Publike në<br>Komunën e Ferizajt. |

Në bazë të nenit 58 pika 1. h. të Ligjit, Nr. 03/L -040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 51 pika 2.9, të Statutit Komunës së Ferizajt 01 Nr. 50, i datës 28.06.2013, Kryetari i Komunës bënë këtë:

### PROPOZIM VENDIM

Propozim - Vendim për ngritjen e tarifave, ndryshimi të Rregullores me 01. Nr.124, për Parkingjet Publike në Komunën e Ferizajt.

### A r s y e t i m

Viteve të fundit janë rritur kostot operative për menaxhimin e parkingjeve publike, përfshirë mirëmbajtjen e infrastrukturës, sinjalizimin horizontal dhe vertikal, paisjet teknologjike, shërbimet administrative dhe kostot e personelit.

Ngritja e tarifave do të mundësonte, harmonizimin e tarifave me çmimet reale të tragut, sigurimin e të hyrave shtesë për investime në kompani, ofrimin e një shërbimi më cilësor dhe më të qëndrueshëm për qytetarë, sigurimin e menaxhimit më efikas të hapësirave publike të parkimit.

Komuna e Ferizajt, përmes Zyrës së Informimit dhe Komunikimit me Publikun, ka përfunduar të gjitha procedurat edhe të konsultimit publik, andaj propozoj që ky dokument të miratohet.



|            |                                                                                                                         |
|------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Nr.Protok: | 143/26                                                                                                                  |
| Datë:      | 17.06.2026                                                                                                              |
| Për:       | Kryetarin e Komunës së Ferizajt<br>z.Agim Aliu                                                                          |
| Cc:        | Drejtorit të Shërbimeve Publike dhe<br>Emergjencë<br>z.Alberton Sahiti                                                  |
| Nga:       | Bordi i Drejtorëve i Ndërmarrjes Publike<br>Lokale "Ambienti" Sh.A Ferizaj dhe<br>Kryeshefi Ekzekutiv<br>z.Arton Gavazi |
| Lënda:     | Kërkesë për ngirtjen e tarifave, ndryshim të<br>Rregullorës për parkingjet publike në<br>Komunën e Ferizajt.            |

I nderuar Kryetar i Komunës së Ferizajt, z.Agim Aliu

Me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Ferizajt është miratuar Rregullorja 01.Nr. 124 për Organizimin dhe Shfrytëzimin e Parkingjeve Publike dhe Private në Territorin e Komunës së Ferizajt. Në mbështetje të dispozitave të rregullorës, duke u bazuar në kompetencat e përcaktuara për administrimin e hapësirave publike të parkimit, propozohet rishikimi dhe ngritja e tarifave të parkingut publik në territorin e Komunës së Ferizajt.



## Arsyetim

Viteve të fundit janë rritur kostot operative për menaxhimin e parkingjeve publike, përfshirë mirëmbajtjen e infrastrukturës, sinjalizimin horizontal dhe vertikal, pajisjet teknologjike, shërbimet administrative dhe kostot e personelit.

Ngritja e tarifave do të mundësonte: Harmonizimin e tarifave publike me çmimet reale të tregut, sigurimin e të hyrave shtesë për investime në kompani, ofrimin e një shërbimi më cilësor dhe më të qëndrueshëm për qytetarët, sigurimin e menaxhimit më efikas të hapësirave publike të parkimit.

Analiza e çmimeve të aplikuara nga operatorët tjerë të parkingjeve në Komunën e Ferizajt, tregojnë se tarifat publike janë dukshëm më të ulëta se çmimet që aktualisht aplikohen në treg.

Duke pasur parasysh se tarifat e propozuara mbasin brenda nivelit të çmimeve të aplikuara në tregun lokal dhe reflektojnë vlerën reale të shërbimit të ofruar, konsiderojmë se ndryshimi i tyre është i arsyeshëm, ekonomikisht i justifikuar dhe në interes të menaxhimit të qëndrueshëm të parkingjeve publike të Komunës së Ferizajt.

Bashkangjitur gjeni edhe listën e propozuar:

**Vërejtje:** Tarifat nuk janë ndryshur që 3 vite

| Emërtimi                                | Çmimi aktual | Ndryshimi  |
|-----------------------------------------|--------------|------------|
| Rr. "Vëllezërit Gërvalla"               | 0.60€ - 1h   | 1€ - 1h    |
| Rr. "Besim Rexhepi"                     | 0.70 € -1h   | 1€ - 1h    |
| Rr. "Ramadan Rexhepi"                   | 0.70 € -1h   | 1€ - 1h    |
| Rr. "Hamëz Jashari"                     | 0.70 € -1h   | 1€ - 1h    |
| Rr. "Tahir Sinani"                      | 0.70 € -1h   | 1€ - 1h    |
| Parkingje në hapësira publike të hapura | 1€ - 8h      | 1€ - 3h    |
| Parking nëntokësor                      | 1€ - 4h      | 1.50€ - 3h |

